



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr.02, datë 21.01.2025

“MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 21.01.2025, mori në shyrtrim projektaktin e hartuar mbështetur në ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore” nenin 30/1 të ligjit nr.57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, V.K.M nr 597, datë 04.09.2019, kreu IV, “Për përcaktimin e procedurave , të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe pasës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike

VENDOSI:

I-Miratimin e kriterëve për dhënien e Ndhmës Ekonomike nga Fondi i Kushtëzuar për Bllok-Ndhmën si më poshtë:

- 1-Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
- 2-Familje me kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
- 3-Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë punë.
- 4-Familje me shumë fëmijë.
- 5- Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin.
- 6- Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë me paaftësi/invalidë pune.
- 7-Familje që kanë një antar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.

II-Dokumentat e aplikuesëve të jenë sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave , të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

III-Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr.597 datë 04.09.2019 “ Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Vendimi u miratua me 10 Vota pro, vota kundër - s`ka , abstënim – s`ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat.

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Elsa PETRITAJ

